



## Deklarata e të drejtave

### I PARAQITET NJË TË MITURI TË VENDOSUR NË PARABURGIM TË MITUR NGA 10 DERI 13 VJEÇ

**Informacionet e mëposhtme duhet t'ju jepen në një gjuhë që e kuptoni.**

**Prindërit tuaj ose përgjegjësit ligjorë, do të marrin të njëjtin informacion, përveç rastit kur kjo gjë është kundër interesit tuaj ose mund të paraqesë rrezik për procedurën. Ju mund ta ruani këtë dokument gjatë gjithë kohës që ndodheni në paraburgim** Ju informojmë se jeni vendosur në paraburgim sepse ndaj jush ekzistojnë prova për të menduar se keni kryer një akt në kundërshtim me ligjin dhe që është i ndëshkueshëm me një dënim prej të paktën 5 vjet burg.

Keni të drejtë të njiheni me faktet për të cilat fajësoheni, datën dhe vendin ku kanë ndodhur si edhe motivet që justifikojnë paraburgimin tuaj.

Ju do të pyeteni rreth këtyre fakteve gjatë mbajtjes në paraburgim i cili mund të zgjasë 12 orë.

Në fund të kësaj periudhe, prokurori (ose gjykatësi i hetimeve ose i fëmijëve) mund të vendosë për zgjatjen e periudhës së paraburgimit me dymbëdhjetë orë të tjera. Me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është e mundur, do të paraqiteni para këtij magjistrati, mundësisht me video-konferencë. Në përfundim të periudhës së paraburgimit, ose do të dilni para këtij magjistrati, ose do të liroheni.

## Ju informojmë se keni të drejtë:

### Të njoftoni disa persona

Prindërit tuaj ose personat apo shërbimet të cilave u jeni besuar, do të njoftohen detyrimisht për paraburgimin tuaj, si dhe për çfarë akuzoheni. Mund të kërkonti që t'i telefononi një personi me të cilin banoni rregullisht, ose një nga të afërmit tuaj të ngushtë, ose një nga vëllezërit ose motrat e tua, ose kujdestarit apo tutorit tuaj lidhur me masën e paraburgimit së cilës i jeni nënshtruar.

Nëse nuk jeni francez, mund të njoftoni gjithashtu autoritetet konsullore të vendit tuaj.

Me përjashtim të rasteve kur nuk është e mundur, këta persona do të njoftohen brenda 3 orësh nga momenti kur keni bërë kërkesën.

### Të komunikoni me një person

Ju mund të kërkonti të komunikoni me shkrim, me telefon ose gjatë një bisede gojarisht me një nga këta persona.

Nëpunësi i policisë mund ta refuzojë kërkesën tuaj nëse e konsideron të rrezikshme. Ai do të përcaktojë se kur dhe si do të bëhet ky komunikim, i cili nuk mund të zgjatë më shumë se 30 minuta. Ky komunikim do të bëhet nën kontrollin e tij.

### Të ekzaminoheni nga një mjek

Gjatë këtyre 12 orëve, do të ekzaminoheni nga një mjek.

Një ekzaminim i dytë do të realizohet nëse masa do të zgjatet.

### Të bëni deklaratë, t'u përgjigjeni pyetjeve ose të rrini në heshtje

Pasi të tregoni se kush jeni, do të keni të drejtën që gjatë seancave :

- të bëni deklaratë,
- t'u përgjigjeni pyetjeve që ju bëhen,
- ose të mos flisni.

## Të shoqëroheni nga përfaqësuesi juaj ligjor

Nëse autoritetet kompetente e mendojnë të nevojshme ju mund të jeni i shoqëruar gjatë seancave ose marrjeve në pyetje, nga persona që janë përgjegjës për ju. Në disa raste, ju mund të caktoni një të rritur tjetër që të jetë shoqëruesi juaj ose mund t'ju shoqërojë një i rritur i caktuar nga gjykata.

## Të asistoheni nga një avokat

**Ju duhet të përfitoni detyrimisht asistencën e një avokati.**

### Zgjedhja e avokatit

Që nga fillimi i periudhës së paraburgimit, në çdo moment gjatë një seance dhe në rastin kur zgjatet paraburgimi, që nga fillimi i kohës së zgjatjes, mund të kërkonti të asistoheni nga një avokat. Ai mund të zgjidhet për ju, nga prindërit tuaj. Përndryshe do të jetë një avokat në detyrë

### Asistenca dhe koha e ndërhyrjes së avokatit

Avokati mund të flasë me ju për 30 minuta me kusht që të garantojë sekretin e bisedës ; në rastin e zgjatjes së paraburgimit, mund të kërkonti përsëri që të takoheni vetëm për vetëm me të.

Nëse ju e kërkonti, avokati mund të qëndrojë pranë jush gjatë seancave të marrjes në pyetje.

Me përjashtim të rastit kur seanca juaj e parë ka të bëjë vetëm me elementët e identitetit, ajo nuk mund të fillojë pa praninë e avokatit tuaj të cilit i jepen dy orë kohë që të mbërrijë. Nëse pas dy orësh avokati juaj nuk ka mbërritur, seanca mund të fillojë. Nëse është e nevojshme për arsye hetimi, marrja juaj e parë në pyetje mund të fillojë menjëherë, edhe në mungesë të avokatit tuaj, me autorizimin e prokurorit ose të gjykatësit të hetimeve ose të fëmijëve.

Nëse avokati mbërrin pasi seanca e marrjes në pyetje të ketë filluar, atëherë ky veprim do të ndërpritet, që të mund të flisni me të.

## Të asistoheni nga një përkthyes

Nëse nuk flisni ose nuk kuptoni frëngjisht, ju keni të drejtë të merrni një përkthyes gjatë seancave të marrjes në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

## Të kërkonti përfundimin e paraburgimit

Kur prokurori, ose gjykatësi të shprehet për një zgjatje të mundshme të masës së paraburgimit, ju mund t'i kërkonti këtij magjistrati që kjo masë të mos zgjatet.

## Të keni akses në disa pjesë të dosjes suaj

Me kërkesën tuaj ose të avokatit tuaj, mund të kërkonti të konsultoheni, jo më vonë se para zgjatjes së mundshme të paraburgimit tuaj :

- me proces-verbalin e njoftimit të vënies suaj në paraburgim ;
- me certifikatat mjekësore të përgatitura nga mjeku që ju ka kontrolluar ;
- me proces-verbalet e seancave të marrjes suaj në pyetje.

## T'i bëni komente prokurorit

Një vit pas përfundimit të periudhës së paraburgimit, minimumi pas një viti, mund t'i kërkonti prokurorit me anë të një letre rekomande të regjistruar me njoftim marrjeje ose me anë të një deklarate të bërë para regjistratit të gjykatës kundrejt lëshimit të një fature, që të konsultoheni me regjistrimet e procedimeve që të bëni komente.

## E drejta për mbrojtjen e privatësisë

Seancat e tua do të filmohen, me përjashtim të rastit kur nuk është e mundur teknikisht.

Askush nuk ka të drejtë që të transmetojë regjistrimet e këtyre seancave. Këto regjistrime mund të transmetohen vetëm në seancat e mbajtura pa praninë e publikut.